

1. Kur parashikohet të finalizohet përlllogaritja e kostos totale të Samitit IV të Diasporës?

Pas përmbylljes së analizës financiare ju informojmë se procesi i llogaritjes së kostos totale të eventit tashme është finalizuar.

2. Ju lutem të më vini në dispozicion dokumentacionin mbështetës (fatura, kontrata, raporte shpenzimesh) që lidhen me organizimin e Samitit.

Samiti IV i Diasporës është organizuar nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë të Kryeministrisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) dhe disa ministrive.

Është miratuar Urdhri nr. 17, datë 06.02.2026, i Kryeministrit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhri nr. 98, datë 09.07.2025, të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për organizimin e Samitit IV të Diasporës”, i cili kryesohet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithashtu, është miratuar Urdhri nr. 68, datë 29.01.2026, i Ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme “Për ngritjen e Grupit Institucional të Punës (GIP) për organizimin e Samitit IV të Diasporës”, ku Grupi Institucional i Punës u kryesua nga zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme që mbulon çështjet e Diasporës.

Ministrinë e përfshira në GNP kanë marrë angazhime sipas paneleve dhe fushave të tyre të përgjegjësisë. Në këtë kuadër, është dakordësuar që Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të realizojë shërbimet e logjistikës, qirasë së sallës (hollit) dhe shërbimit ushqimor, si institucion që ka funksion administrativ organizimin e aktiviteteve të kësaj natyre, në përputhje me standardet e organizimit të samiteve dhe kërkesat operative e protokollare të eventit, bazuar në komunikimet dhe shkresat përkatëse.

Në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar, më datë 03.04.2026 është lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet AKD dhe DSHQ për organizimin e eventit “Samiti IV i Diasporës”, në Tiranë në datat 13–15 prill 2026. Objekti i kësaj marrëveshjeje është ofrimi nga ana e DSHQ-së i shërbimeve të logjistikës dhe mbështetjes organizative gjatë zhvillimit të Samitit, duke i vënë në dispozicion palës organizatore MEPJ/AKD strukturat dhe shërbimet e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit.

3. Për secilin nga zërat kryesorë të shpenzimeve (infrastrukturë logjistike, akomodim, pritje–përcjellje), ju lutem të specifikoni vlerat përkatëse.

Shpenzimet për mbarëvajtjen e këtij evendi janë mbuluar nga buxhetet AKD dhe MEPJ.

Përsa i takon shpenzimeve dhe zërave që ka mbuluar Agjencia Kombëtare e Diasporës informojmë se totali i vlerës së faturuar për shërbimet e ofruara nga DSHQ (shërbim logjistik, qira ambienti dhe catering) është **39,731,924** (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e

nëntëqind e njëzet e katër) lekë, ndërsa shpenzimet e përballuara nga MEPJ janë në vlerën **2,220,594** lekë.

4. Cila është kostoja mesatare për pjesëmarrës?

Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit, në Samit u regjistruan gjithsej 1,121 pjesëmarrës përmes platformave online të dedikuara për regjistrimit. Përveç tyre, 68 persona u regjistruan fizikisht gjatë aktivitetit. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ka qenë edhe më i lartë, pasi në aktivitet morën pjesë panelistë, përfaqësues të medias dhe persona të tjerë të interesuar, të cilët nuk ishin domosdoshmërisht pjesë e listave të regjistrimit.

Bazuar në të dhënat e disponueshme dhe nivelin e pjesëmarrjes, ky ishte Samiti me interesimin dhe pjesëmarrjen më të lartë krahasuar me tre edicionet e mëparshme.

5. Për panelistët e diasporës, ju lutem të specifikoni shumat e mbuluara nga buxheti i shtetit për udhëtim dhe akomodim.

Samiti u zhvillua përmes 19 paneleve tematike, me pjesëmarrjen e 139 panelistëve nga Shqipëria dhe diaspora, duke përfaqësuar institucione, organizata, ekspertizë profesionale dhe komunitete të ndryshme shqiptare në botë. Në përputhje me përgjegjësitë organizative të secilit panel, shpenzimet e pjesëmarrjes për panelistët e ftuar janë mbuluar nga institucionet organizatore përkatëse, sipas fushave që ato kanë koordinuar.

6. A ka një raport përfundimtar të Samitit që përfshin analizën financiare dhe organizative? Nëse po, ju lutem ta vini në dispozicion.

Është finalizuar Raporti Përfundimtar i Samitit të IV të Diasporës, duke reflektuar aspektet kryesore të organizimit dhe realizimit të aktivitetit. (jo aspektet financiare). Publikimi i tij në faqen e MEPJ pritet të bëhet në ditët në vijim, pas së cilës do të shpërndahet gjerësisht.